



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **08/2025**

Data: **28 janar, 2025. Ora: 14:30**

Vendi: **Votim në procedurë qarkulluese (online)**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 07/2025

3. Aktivitetet e Zyrës

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditimin e vëzhguesve
-

4. Këshillat e KQZ

4.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 4.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KKZ në komunën e Deçanit
- 4.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të lokacionit të QV 1127 në komunën e Mitrovicë e Jugut;
- 4.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të lokacionit të QV 1207 në komunën Leposaviq
- 4.1.4. Shqyrtimi dhe emërimi i KVV sipas komunave përkatëse
- 4.1.5. Shqyrtimi dhe emërimi i KVV sipas në përfaqësitë diplomatike
- 4.1.6. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për mbylljen e të QV jashtë Kosovës

4.2. Këshilli për Informim Publik

- 4.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe slloganit për fushatën e informimit publik për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025

5. Të ndryshme

Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: Kryetari Radoniqi, pasqyroi agjendën e takimit, ndërsa Arianit Elshani, tha se zëvendësimi i asamblistit bëhet për komunën e Obiliqit dhe jo të Deçanit. Gjithashtu, propozoi të largohet pika “Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të lokacionit të QV 1207 në komunën Leposaviq”, pastaj të largohen edhe pikat: “Shqyrtimi dhe emërimi i KVV sipas komunave përkatëse” dhe “Shqyrtimi dhe emërimi i KVV sipas në përfaqësitë diplomatike”. Z. Elshani, dha arsyetimet lidhur me propozimet e tij si kryesues i KOZ-it. Besnik Buzhala, propozoi një pikë: “Autorizimin e drejtorit që të lidhë marrëveshje me palët e treta”. Ai tha se, në këtë rast, ka të bëjë me Autoritetin Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për shërbime shtesë të Prokurimit. Marrëveshja e KQZ-së me ARrKEP-në, ekziston. Alban Krasniqi, pyeti nëse ka propozim për blerje, shërbime për shmangie të procedurave...? Mufera Shinik, tha se me 8 janar është marrë vendim lidhur me Fletëvotimet. Ajo, bëri vërejtje lidhur me përdorimin e

gjuhëve. Tha se, ka kërkuar që sipas ligjit për përdorimin e gjuhës të respektohet gjuha turke. Ajo, dha arsyetimet e saj pse, dhe tha se ka vërejtje të cilat nuk po merren parasysh...

Me ndryshimet e bëra, me 10 vota për u miratua agjenda.

Në vazhdim, u miratua procesverbali nga mbledhja nr. 07/2025 me dy abstenime (Sami Kurteshi) u miratua procesverbali.

Aktivitetet e Zyrës

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditimin e vëzhguesve

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës, paraqiti një raport të gjerë (5 grupe) lidhur me rekomandimet për akreditim të e vëzhguesve:

Grupi 1: Bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, i rekomandon KQZ që të marr vendim për akreditimin e institucioneve zgjedhore të shteteve të huaja, si organizata vëzhguese dhe listën me emrat e vëzhguesve, si në vijim:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë, me 2 vëzhgues;
2. Komisioni Shtetërorë i Zgjedhjeve i Republikës së Kroacisë, me 2 vëzhgues;
3. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Malit të Zi, me 3 vëzhgues;
4. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me 2 vëzhgues;
5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Bullgarisë, me 2 vëzhgues;
6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Armenisë, me 2 vëzhgues;

Me 8 vota për, miratohen...

Grupi 2: Institucioni i avokatit të popullit, ka përfunduar aplikimin për gjashtëdhjetë e shtatë (67) vëzhgues, të cilët: a) nuk janë kandidatë për post zgjedhor në Kosovë. B). Të gjithë vëzhguesit janë votues në listën përfundimtare të votuesve. Zyra, rekomandon KQZ akreditimin e gjashtëdhjetë e shtatë (67) vëzhguesve.

Me 10 vota për, miratohen...

Grupi 3: Për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që mbahen me datën 09.02.2025, afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve të përfaqësive diplomatike në Republikën e Kosovës, ka përfunduar me datën 25 janar 2025. Zyra, i rekomandon KQZ që të marr vendim për akreditimin e përfaqësive diplomatike në Republikën e Kosovës, si organizata vëzhguese dhe listën me emrat e vëzhguesve, si në vijim:

1. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me 24 vëzhgues;
2. Ambasada e Britanisë, me 30 vëzhgues;
3. Ambasada e Gjermanisë, me 2 vëzhgues;
4. Ambasada e Francës, me 6 vëzhgues;
5. Ambasada e Italisë, me 1 vëzhgues;
6. Ambasada e Holandës, me 3 vëzhgues;
7. Ambasada e Japonisë, me 5 vëzhgues;
8. Ambasada e Finlandës, me 2 vëzhgues;
9. Ambasada e Suedisë, me 2 vëzhgues;
10. Ambasada e Turqisë, me 8 vëzhgues;

Me 10 vota për, akreditohen...

Grupi 4: Për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që mbahen me datën 09.02.2025, afati i fundit për aplikim për akreditim të vëzhguesve të organizatave jo qeveritare ka përfunduar me datën 25 janar 2025. Organizatat jo qeveritare kanë plotësuar të gjitha kriteret për tu akredituar si vëzhgues. Bazuar në shqyrtimet e zyrës, rekomandojmë KQZ –në që të marr vendim për akreditimin e Organizatës jo qeveritare, si në vijim:

1. Instituti i Kosovës për Demokraci (KDI), me 306 vëzhgues;
2. Lëvizja FOL, më 6 vëzhgues;

3. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me 48 vëzhgues;
4. Rjeti i OJQ-ve AVONET, me 4 vëzhgues;
5. Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), me 140 vëzhgues;
6. Democracy Plus, me 11 vëzhgues;
7. Qendra Kulturore Orfeu, me 154 vëzhgues;
8. Germin, 16 vëzhgue;
9. Demokracia për Zhvillim (D4D), me 9 vëzhgues;
10. Syri i Vizionit, me 124 vëzhgues;
11. Rinia për Zhvillim dhe Bashkëpunim, me 14 vëzhgues;
12. INTERNEËS KOSOVA, me 21 vëzhgues;
13. PIPOS, me 81 vëzhgues;
14. Youth Association for Human Rights, me 2 vëzhgues;
15. Kosovo Center for International Cooperation, me 56 vëzhgues;
16. Udruženje Gradjana RESTART, me 24 vëzhgues;
17. Primo la Tolleranza, me 17 vëzhgues;
18. Centre For Social Inclusion Gračanica, me 27 vëzhgues;
19. Center for Cooperation and Networking of Organizations, me 13 vëzhgues;
20. Centar za Mir i Toleranciju Pristina, me 36 vëzhgues;
21. ADVOCACY CENTER FOR DEMOCRATIC CULTURE, me 17 vëzhgues.

Alban Krasniqi, pyeti rreth kapaciteteve të organizatave. Ai, kërkoi shpjegim se për shembull, KDI ka paraqitë 306 vëzhgues. Le të dihet se, kënd ata i kanë marrë vëzhgues dhe se ato, mbajnë përgjegjësi për vëzhguesit e tyre. Është edhe detyrë e jona, ti pajisim me informacione por edhe për detyrat dhe përgjegjësitë që vëzhguesit kanë...

Me 10 vota për, miratohen...

Grupi 5: Po ashtu, tha z. Buzhala, bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 08/2024 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, zyra rekomandon për akreditimin e organizatave ndërkombëtare, si organizata vëzhguese dhe listën me emrat e vëzhguesve, si në vijim:

1. Association of World Election Bodies, 2 vëzhgues;
2. Elections Quebec – RECEF, me 3 vëzhgues;
3. European Dialogue and Democracy Association (EDDA Norëay), me 24 vëzhgues;
4. European Platform for Democratic Elections, me 23 vëzhgues;
5. EUROPEAN UNION ELECTION OBSERVATION MISSION KOSOVO 2025, me 163 vëzhgues;
6. Institut de Coopération et Développement, me 60 vëzhgues;
7. International Foundation for Electoral Systems (IFES), me 5 vëzhgues;
8. International Institute for Democracy and Electoral Assistance (International IDEA), me 2 vëzhgues;
9. Nacional Democratic Institute, me 35 vëzhgues;
10. Parliamentary Assembly of the Council of Europe, me 54 vëzhgues;
11. Zyra e BE në Kosovë, me 19 vëzhgues;
12. International Republican Institute, me 3 vëzhgues.

Alban Krasniqi, tha se duhet të përgatiten materialet në gjuhën angleze, aq sa është e mundur meqë, kemi organizata ndërkombëtare...

Me 10 vota për, miratohen pa 5 vëzhgues të IFES.

Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KKZ në komunën e Obiliqit:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar zëvendësimit të anëtarit të KKZ në komunën e Obiliqit për shkak të një vendimi të PZAP-së. Pra, Selim Asllani, zëvendëson anëtarin e kaluar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe ne, rekomandojmë për miratim.

Me 10 vota për, miratohet ky zëvendësim.

Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të lokacionit të QV 1127 në komunën e Mitrovicë e Jugut:

Arianit Elshani, tha se është shqyrtuar edhe kërkesë për caktimin e qendrës së votimit në fshatin Mazhiq. Bëhet fjalë për lokacionin e QV 1127 në komunën e Mitrovicë e Jugut. Qendra ishte e propozuar në një shkollë, por që nuk i plotësonte kushtet sepse, ishte e demoluar, jo e përshtatshme. SKQZ ka identifikuar një shtëpi private e cila, do të paguhet. Dhe ne, rekomandojmë për miratim.

Me 10 vota për, miratohet ndryshimit të lokacionit të QV 1127 në komunën e Mitrovicë e Jugut, përkatësisht në fshatin Mazhiq.

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për mbylljen e të QV jashtë Kosovës:

Arianit Elshani, tha se e kemi shqyrtuar një rekomandim të ardhur nga Sekretariati që, është bërë edhe në konsultim me MPJ-në. Bëhet fjalë për mbylljen e 3 QV jashtë vendit. Janë njoftuar përfaqësitë diplomatike: 1. Kanberra – Australi që kishte 18 votues të regjistruar. 2. Ankara – Turqi, me 25 votues të regjistruar. 3. Ajova-SHBA me 32 aplikues. Të gjithë këta votues, do të rekomandohen që të votojnë me postë...

Me 9 vota për dhe një abstenim (Sami Kurteshi), miratohet ky rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i autorizimit të drejtorit për lidhje të marrëveshjeve me palët e treta:

Besnik Buzhala, tha se ky propozim ka të bëjë me Autoritetin Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për shërbime shtesë të Prokurimit. Marrëveshja e KQZ-së me ARrKEP-në, ekziston. Ne, na duhet ti marrim shërbimit edhe të një zyrtari të prokurimit. Buzhala, raportoi edhe arsyet...

Me 10 vota për, u miratua kjo kërkesë.

Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të prokurimit për funksionimin e pajisjeve të IT në Qendrat Komunale të Numërimit. (QKN):

Besnik Buzhala, rekomandoi që të miratohen procedurat për funksionimin e pajisjeve të IT në Qendrat Komunale të Numërimit. (QKN). Marrja me qira e pajisjeve të IT. Ai, tregoi se për cilat pajisje është fjala...

Diskutuan: Arianit Elshani, Alban Krasniqi,

Me 10 vota për, miratohet kërkesa.

Këshilli për Informim Publik

Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe sloganit për fushatën e informimit publik për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani, tha se këshilli ka shqyrtuar dizajnet dhe shtypin. Kemi kontraktuar kompaninë. Gjithashtu, është shqyrtuar edhe slogani. Ai, paraqiti sloganin dhe dizajnin që këshilli e ka shqyrtua, dhe ne rekomandojmë për miratim.

Me 10 vota për, miratohet dizajni dhe slogani për fushatën e informimit publik.

Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës së anëtarësisë së KQZ-së në rrjetin e Frankofonisë:

Kreshnik Radoniqi, tha se e kemi diskutuar këtë pikë në mbledhjen e kaluar. Nuk e kemi në buxhet, por nuk është shumë e madhe dhe ne duhet ta paguajmë anëtarësinë. Shuma është: 2,500 euro.

Me 10 vota për, miratohet.

Të ndryshme !

Gordana Llaban, kërkoi që materialet të sillen së pak 1 orë para takimeve. Nuk ka lidhje në cilën gjuhë, por na duhet ti kemi...